



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo			
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije			
Ministry of Finance			
Arkiva - Arhiva - Archive			
Nr. Org.	06/LCO	Nr. Prot.	256-3/2021
Org. Jedin.		Org. Prot. No.	
Nr. i fletëve		Data	02, 11 / 21
Broj shtetësh		Data	
No. pages.		Data	
Prishtinë/A			

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve**  
**Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers**  
**Departamenti i Buxhetit - Odeljenje Budžeta - Budget Department**

DATE	27.10.2021
REFERENCË	NR. - 286 / 2021
PËR/ZA/TO:	Z. Visar Rrecaj, Udhëheqës e Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate, MPJD
CC:	Znj. Elmaze Pireva, zv. Sekretare e Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Enis Spahiu, zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave
NGA/OD/FROM:	Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Ministria e Financave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinionimi i Departamentit të Buxhetit për Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi në kontekst të aderimit në Bashkimin Evropian

I nderuar z. Rrecaj,

Bazuar në kërkesën për Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor për Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi në kontekst të aderimit në Bashkimin Evropian, obligimin sipas nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe nenit 19 të Ligjit Nr. 07/L-041 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.

Departamenti i Buxhetit paraqet me sa vijon:

## I. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj ka për qëllim që të ratifikojë marrëveshjen në kontekstin e aderimit në Bashkimin Evropian ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi.

## II. OPINIONI PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT BUXHETOR (VNB) TË PROJEKTLIGJIT NGA INSTITUCIONI PROPOZUES

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) si organ propozues ka përgatitur vlerësimin e ndikimit buxhetor të këtij projektligji dhe e ka paraqitur përmes formularit të vlerësimit të ndikimit buxhetor, sipas të cilit vlerësohet që ky Projektligj nuk do të ketë implikime shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Ndarjet buxhetore të parapara për Drejtoratin e Drejtorisë së Përgjithshme (DDP) në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), nën program ky i cili është i obliguar të zbatohet në praktikë këtë projektligj.

Kjo ndarje buxhetore e shpërndarë për vite dhe kategori të shpenzimeve është si vijon:

Vitet	2021	2022	2023
Paga dhe Mëditje	306,185	307,716	309,254
Mallra dhe Shërbime	300,000	300,000	300,000
<b>Gjithsejtë</b>	<b>606,185</b>	<b>607,716</b>	<b>612,771</b>

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, palët kontraktuese përfshihen institucionet tjera relevante qeveritare, do të mbajnë konsultime në nivel operativ sa i përket:

- Reformës së legjislacionit dhe harmonizimit të legjislacionit kombëtar me acquies,
- Tendencave aktuale dhe evoluese në procesin e aderimit në BE,
- Menaxhimit të instrumentit të ndihmës para anëtarësimit dhe ndihmave tjera që lidhen me integrimin e të dy vendeve në BE,
- Shkëmbimit të eksperteve në fushat me interes të ndërsjellë, dhe
- Ndihmës me ekspert dhe ndihmës administrative

#### **PËRFUNDIM:**

Departamenti i Buxhetit - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve shpreh opinionin e vet të pavarur për vlerësimin e ndikimit buxhetor për Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi në kontekst të aderimit në Bashkimin Evropian, sipas të cilit vlerësojmë që zbatimi në praktikë i këtij projektligji nuk paraqet kosto shtesë buxhetore për MPJD - Drejtoratin e Drejtorisë së Përgjithshme si zbatuese e këtij projektligji, bazuar në ndarjet buxhetore me Ligjin Nr. 08/L-016 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 dhe vlerësimet për vitet 2022 dhe 2023.

Përgatitur nga:

Bashkim Mehmetaj, Analist i Lartë i Buxhetit për MPJD



Konfirmoi:

Milaim Aliu, Udhëheqës i Divizionit të Buxhetit Qendror

